

K O N F E R E N C Ë

“RISITË DHE PROBLEMATIKAT NË ZBATIMIN PËR HERË TË PARË TË SKK-ve TË PËRMIRËSUARA”

07 Qershor 2016

Të nderuar të ftuar!

Të nderuar kolegë dhe miq gjithashtu!

Ndjehem shumë i nderuar t’ju kem sot këtu, në punimet e kësaj konference, pasi prezenca juaj konfirmon më së miri se KKK është kthyer në një organizëm të rëndësishëm dhe të qenësishëm rregullator, i cili, *e them këtë pa modesti*, është tashmë një Institucion avanguard për sa i përket përqaimit të të gjitha risive në nivel ndërkombëtar në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Pse e them këtë...shumë prej jush i janë bashkuar KKK-së në konferencën e zhvilluar në Maj 2013. Në atë konferencë, përveç punës së bërë deri në atë moment, u promovua vizioni dhe aktivitetet e ardhshme të KKK-së. Por në këtë periudhë tre vjeçare u bënë realitet jo vetëm sa ishin planifikuar por dhe të tjera, disa prej të cilave janë akoma në proces. Po ndalem në fillim tek çfarë u tha në atë konferencë për të ardhmen e afërt:

- a) Do të bëhej pjesë e detyrave vjetore të KKK-së konsolidimi i SNRF-ve të përkthyer në gjuhën shqipe, jo më vonë se 6 muaj nga publikimi i ndryshimeve të përvitshme nga IASB;
- b) Do të përmirësoheshin SKK-të ekzistuese duke i përafruar ato thelbësisht me SNRF për NJVM, brenda vitit 2013;
- c) Pasqyrat financiare do të rishikoheshin për t’u harmonizuar me kërkesat e paraqitjes së pasqyrave sipas Direktivës së BE-së;
- d) Gjithçka sa më sipër do të bëhej në një proces transparent me publikun dhe në bashkëpunim me palët e interesit;

Atëherë po i marr me rradhë, por pa u ndalur gjatë tek secili prej aktiviteteve të premtuar e të promovuar, për realizimin e vizionit të KKK-së.

Pjesë e vizionit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit ishte lehtësimi i përdorimit të SNRF-ve për njësitë ekonomike **me** interes publik, që mbështetej në përkthimin e vazhdueshëm të SNRF-ve;

- *Çfarë është bërë për përkthimin dhe konsolidimin e SNRF-ve.....*Me ndihmën financiare të Projektit të Bankës Botërore, KKK-së iu mundësua një program shumë i avancuar përkthimi, programi TRADOS dhe në të njëjtën kohë me fondet e projektit u trajnuar stafi i KKK-së për përdorimin e këtij programi. Komiteti i Rishikimit, i përbërë nga dy përkthyes dhe 2 rishikues, **të cilët përfitoj nga rasti t'i përgëzoj për punën e shkëlqyer që kanë bërë**, në bashkëpunim me stafin e KKK-së sot e kanë kthyer në realitet të prekshëm konsolidimin në kohë reale të SNRF-ve, pra jo më vonë se 6 muaj nga publikimi i variantit të konsoliduar të SNRF-ve nga Bordi i Londrës. Varianti i konsoliduar i SNRF-ve publikohet në faqen zyrtare të KKK-së vetëm pasi ndryshimet e përkthyer shpallen të detyrueshme për zbatim nga Ministri i Financave. Sot të gjitha njësitë ekonomike që plotësojnë kriteret për zbatimin e detyrueshëm të SNRF-ve kanë mundësinë t'i konsultojnë apo përdorin ato në gjuhën shqipe, shumë kohë përpara datës efektive të tyre.

Në këtë proces palët e interesuara u përfshinë duke u bërë pjesë e Komitetit të Rishikimit, si anëtarë të tij. Anëtarët e këtij Komiteti kanë një mandat 2 vjeçar me qëllim përfshirjen e një numri në rritje të palëve të interesit në procesin e përkthimit dhe rishikimit të SNRF-ve në gjuhën shqipe.

Pjesë e vizionit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit ishte publikimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të qarta dhe të kuptueshme për njësitë ekonomike **pa** interes publik (SKK-të e përmirësuara):

- *Çfarë u bë për përmirësimin e SKK-ve.....*Si detyrë të parë në trajtimin e kësaj çështjeje, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit miratoi qasjen strategjike si në vijim:

1. Miratimi i trajtimit kontabël të kërkuar në SNRF për NJVM, si trajtimi "bazë", në të gjitha Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara; dhe

2. Rast pas rasti, kur SNRF-të për NVM të kishin një trajtim të ndryshëm apo një çështje krejt të re kontabël, të konsiderohej nevoja për lejimin e një trajtimi alternativ apo shtimin e një seksioni të ri brenda Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara;

Pas një pune shumë impenjative u arrit që drafti i parë për komente të publikohej, ashtu si ishte parashikuar, me afat dhjetor 2013, drafti i dytë i ripunuar me afat mars 2014 dhe drafti final me afat 15 qershor 2014. Pas tre publikimesh për komente, KKK miratoi SKK-të e përmirësuar dhe i dërgoi ato për shpallje tek Ministri i Financave. Me Urdhër nr.64, datë 22.07.2014, Ministri i Financave i shpalli SKK-të e përmirësuara të detyrueshme për zbatim prej janarit 2015.

Sot hartuesit e pasqyrave financiare por dhe përdoruesit e tyre kanë në dorë jo vetëm paragrafët e standardeve të përmirësuara por edhe bazën e konkluzioneve për ndryshimet e bëra referuar SKK-ve të 2008. Dhe çka është shumë e rëndësishme të thuhet, për herë të parë pas vitit 2008, çdo standard shoqërohet me udhëzuesin e tij për zbatim. Besoj të gjithë i keni parë dhe shfrytëzuar materialet e udhëzuesit të cilat janë të mbushura me ilustrime shpjeguese dhe numerike.

SKK-të e përmirësuara sollën disa çështje të reja të patrajtuara më parë si p.sh, trajtimi i koncesioneve apo trajtimi i aktiveve afatgjata materiale të investuara por më së shumti sollën ndryshime në çështje të matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të elementeve të pasqyrave financiare si p.sh në rastin e instrumenteve financiare, aktiveve biologjike, kostos së huamarrjes, shpenzimeve të zhvillimit, njohjes së granteve, amortizimit të emrit të mirë, etj.

Nuk janë të pakta ndryshimet, por me besimin se në këto vite profesionistët shqiptarë patën mundësinë të perfeksionohen në përdorimin e SKK-ve të 2008, këto ndryshime të miratuara janë lehtësisht të absorbueshme si nga hartuesit ashtu dhe nga përdoruesit. Por besimin tonë presim që ta forcojmë më shumë pas kësaj konference ku ju do të paraqisni komentet apo shqetësimet tuaja.

Pjesë e vizionit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit ishte hartimi i pasqyrave të reja financiare në përputhje me kërkesat e raportimit financiar të Direktivës së BE për kontabilitetin;

• *Çfarë u bë për përditësimin e pasqyrave financiare sipas SKK-ve të përmirësuara....* Meqenëse Shqipëria është vend kandidat për anëtarësimin në BE,

reformat në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë rrugë për t'u shkelur. Në këtë kontekst transpozimi i Direktivës, ose të një pjese të konsiderueshme të saj, e cila ka të bëjë me paraqitjen e pasqyrave financiare, u konsiderua si një detyrë dhe sfidë për t'u përballur. Dhe sot, pasqyrat që ju si hartues dhe përdorues keni ndërtuar dhe vlerësuar, janë produkt i kësaj strategjie, **transpozimi i Direktivës**.

Pasqyrat e reja financiare u shoqëruan, edhe pse pak me vonesë, me komentarin për mënyrën e plotësimit të tyre, i cili përmbante edhe listën e re të përmirësuar të llogarive. Them pak me vonesë pasi ishte një angazhim i paplanifikuar më parë, por produkt i vullnetit të mirë për të dhënë maksimumin në rolin e rregullatorit në fushën e raportimit financiar.

Komentari, për ata profesionistë që akoma nuk e disponojnë, është një material ku qartazi tregohet lidhja mes numrave të llogarive të listës dhe posteve përkatëse në pasqyrat financiare. Ky komentari përveç se lehtëson punën e hartuesve të PF, jemi të bindur që lehtësoi sidomos tranzicionin nga pasqyrat ekzistuese në pasqyrat e reja financiare. Nuk ishte e lehtë që në një periudhë të shkurtër kohe të përgatitej nga KKK një material i qartë dhe i kuptueshëm për të përballuar tranzicionin, por them se ia arritëm.

Po në këtë proces të përmirësimit të SKK-ve dhe përditësimit të Pasqyrave financiare si u realizua përfshirja e palëve të interesit?

Përfshirja, në veçanti, e profesionistëve të kontabilitetit por edhe e palëve të tjera të interesit u mundësua kryesisht nga kontaktet e drejtpërdrejta në tryeza të rrumbullakëta dhe nga përdorimi i mediave moderne të komunikimit.

Tryezat e rrumbullakëta jemi përpjekur që të mbulojnë jo vetëm numerikisht por dhe gjeografikisht një shpërndarje të konsiderueshme të pjesëmarrësve. Tryezat janë zhvilluar sipas tematikave në disa rrethe si p.sh, Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër. Dëshira do të ishte të shkonim në çdo qytet por mundësitë financiare dhe burimet njerzore në dispozicion i kufizojnë lëvizjet tona.

Prandaj për një shtrirje shumë më të gjerë kemi përdorur median online. Publikimi për komente i drafteve të njëpasnjëshme në faqen zyrtare të KKK, shpërndarja me email tek të gjithë organizmat profesionalë të materialeve për diskutime, përdorimi i platformave online për punën në grupe ku përfshiheshin përfaqësues të palëve të interesit si dhe ndonjë mundësi tjetër e papërmendur më

lart, kanë qenë të gjitha rrugë komunikimi online që përfshinë në masë të konsiderueshme palët e interesuara në këtë proces.

Ndërsa jemi shumë të kënaqur që palët e interesit mirëpresin dhe angazhohen seriozisht së bashku me KKK-në në proceset e reformës së përmirësimit të raportimit financiar, gjej rastin të them një të vërtetë që nuk na pëlqen. Tatimorët, një hallkë shumë e rëndësishme e procesit, nuk janë dhe aq aktivë dhe bashkëpunues në këtë drejtim. Do të vlerësonim një tjetër qëndrim të tyre, pasi nga bashkëpunimi mes dy institucioneve do të sigurohej jo vetëm një harmonizim më i mirë i kërkesave kontabël me kërkesat e raportimit fiskal por dhe ngritja e kapaciteteve të inspektorëve tatimorë në drejtim të SKK-ve do të kishte qenë një proces më i suksesshëm.

Pa dashur të tregoj më shumë për punën e bërë nga KKK, vizionin e saj të kthyer në realitet, unë dhe anëtarët e tjerë të KKK-së presim që në këtë foltore të konferencës të jepen, në mos të gjitha, të paktën vlerësimet më kryesore për risitë dhe problematikat që sollën SKK-të e përmirësuara dhe pasqyrat e reja financiare pasi ndryshimet nuk bëhen për të qenë teorikisht dhe burokratikisht të përditësuar por që praktika të ofrojë shanse më të mëdha të një raportimi të drejtë e të vërtetë dhe njësitë ekonomike të përfitojnë prej tyre në marrjen e vendimeve ekonomike dhe menaxheriale sa më të drejta.

Ashtu si përmenda më lart, KKK në periudhën pas konferencës së maj 2013, ka bërë edhe më shumë nga sa kish parashikuar për një periudhë tre vjeçare. Dua vetëm të përmend disa anagazhime të rëndësishme pasi produktet finale ju ose i dispononi ose shumë shpejt do t'ju vihen në dispozicion për përdorim.

Angazhimi i parë - Në periudhën 2014 / 2015, u punua për hartimin e një standardi të posaçëm për OJF-të. Ishte një angazhim i vështirë pasi ishte eksperiencë e re përshtatja me kërkesat e njësitë ekonomike **jofitimprurëse**. Duke shfrytëzuar literaturën ndërkombëtare, eksperiencën vendase dhe sidomos konsulencën e huaj që na mundësoi projekti i Bankës Botërore, u mundësua publikimi për komente i SKK për OJF më fund të majit 2015. Pas periudhës tre mujore për komente, KKK e miratoi këtë Standard në shtator 2015 dhe po në këtë muaj e dërgoi për shpallje tek Ministri i Financave. Me Urdhër Nr. 62 datë 17.09.2015, Ministri i Financave shpalli SKK për OJF-të të detyrueshëm për zbatim që prej janarit 2016. Pasqyrat e para të hartuara sipas këtij standardi do të mund t'i

kemi në pranverën e vitit që vjen prandaj dhe komentet për risitë dhe problematikat e tyre do t'i diskutojmë në një tjetër event të ngjashëm të KKK-së.

Lidhur me këtë standard, sërish me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore, KKK do të punojë për hartimin e udhëzuesit në zbatim të tij, që gjithashtu do të përmbajë mjaftueshëm shpjegime, interpretime dhe ilustrime numerike për raste që i përgjigjen nevojave të OJF-ve në vendin tonë.

Angazhimi i dytë - Në fund të 2015, në vijim të përmirësimit të SKK-ve, u mor vendimi për përmirësimin e SKK 15. Ky standard ka kaluar fazën e diskutimeve në mbledhjet e KKK-së dhe aktualisht është publikuar për komente në faqen zyrtare të KKK-së. Afati për komente është deri më 31 gusht 2016. Standardi ka pësuar ndryshime jo vetëm tek paragrafët por dhe tek paraqitja e pasqyrave financiare. Nuk po flas më gjatë për të mos shuar kuriozitetin tuaj mbi SKK 15 e përmirësuar por ju them se jeni sinqerisht shumë të mirëpritur me komentet tuaja në faqen zyrtare të KKK-së për vetë rëndësinë dhe zbatueshmërinë që ky standard ka.

Angazhimi i tretë – Rishikimi i ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Ligji i kontabilitetit konsiderohet një nga ligjet e punuara më mirë pasi ka funksionuar pa krijuar probleme në zbatimin e tij që prej vitit 2004. Gjithësesi vetë zhvillimet, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar bënë domosdoshmëri disa ndërhyrje në këtë ligj. Ndryshimet e propozuara nga KKK, në përputhje me procedurat normale për miratimin e amendimeve ligjore, i janë dërguar Ministrisë të Financave për mendim. Ndër ndryshimet kryesore të propozuara në këtë ligj nga KKK po përmend si më poshtë:

- Përditësimi i terminologjisë;
- Përkufizime dhe koncepte të reja ku merr rëndësi përkufizimi i njësive ekonomike **ME** dhe **PA** interes publik;
- Bëhen pjesë e ligjit “grupet e njësive ekonomike”e për rrjedhojë shtohen dispozita që rregullojnë kontabilitetin dhe raportimin financiar të tyre;
- Rregullohet përgjegjësia për hartimin dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare (ky rregullim i munguar në ligj ka krijuar problematika të ndryshme sidomos në rastet kur hartues të pasqyrave financiare janë përfaqësuesit tatimorë, duke krijuar kështu premisën për krijimin e një tregu informal brenda profesionit);

- Rregullohet raportimi financiar i **rregullatorëve** në sektorin bankar, jo bankar dhe financiar;
- Lehtësohet një barrierë ekzistuese për njësitë ekonomike që operojnë në monedha të huaja duke lejuar tashmë kontabilitetin e tyre në monedhën funksionale gjatë ushtrimit kontabël pa ndryshuar kërkesën që pasqyrat financiare të paraqiten në monedhën vendase;
- Përmirësohen kërkesat për zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar duke zgjeruar mundësinë e përfaqësimit të më shumë sektorëve në Këshill por dhe duke kufizuar mandatin e Anëtarit me qëllim mundësinë e përfaqësimit dhe kontribuimit në Këshill të më shumë personaliteteve nga fusha dhe sektorë të ndryshëm;
- Shtohet kërkesa për dhënie informacioni lidhur me numrin e të punësuarve në njësinë ekonomike;
- Rregullohet raportimi për periudhën e raportimit në rast të fillimit apo ndërprerjes së veprimtarisë në një periudhë jo më të gjatë se tre muaj para ose pas përfundimit të ushtrimit kontabël, është në përputhje me procedurat e përcaktuara për falimentimin;
- Përputhen kërkesat për publikimin e pasqyrave financiare me kërkesat e përcaktuara nga ligji për QKB-së;
- Sanksionohet me ligj e drejta e KKK për të monitoruar zbatueshmërinë e standardeve të kontabilitetit, pra forcon kërkesën e formuluar në VKM 742, 07.11.2007, pika 3 “Për kriteret e përzgjedhjes së njësive ekonomike që duhet të zbatojnë SNK-të”.

Së fundmi desha të ndaj me Ju dhe angazhimin e ardhshëm të KKK-së në Projektin **“Përmirësimi i Cilësisë së Raportimit Financiar”**.

Përtej arritjeve në fazën e parë të projektit, ka akoma shumë për të bërë në përmirësimin e raportimit financiar në Shqipëri. Projekti “Përmirësimi i Cilësisë së Raportimit Financiar”, si fazë e dytë e implementimit të Planit të Veprimit për Shqipërinë, në të cilin KKK-ja është një nga përfituesit, synon përmes një qasje programore të integruar të mbështesë përmirësimin e raportimit financiar në një kontekst më të gjerë.

Përmes përpjekjeve të përbashkëta me KKK-në, konsulentët e projektit do të punojnë për të ofruar trajnime për një numër të konsiderueshëm profesionistësh lidhur me SKK-të dhe SNRF-të.

Angazhimet që do të ndërmerren në fazën e dytë të projektit janë:

- tabela e përputhshmërisë që do të mundësojë transpozimin e disa kërkesave të Direktivës së BE për kontabilitetin, në ligjin tonë apo tek SKK-të, kërkesa të cilat nuk janë pjesë e legjislacionit tonë kontabël;
- trajtimi i çështjes së klasifikimit të njësive ekonomike, duke i sjellë kriteret e klasifikimit të tyre më afër me ato të parashikuara në Direktivë si dhe harmonizimi i tyre në tërësinë e legjislacionit shqiptar;
- diferencim më i mirë i kërkesave për shënime shpjeguese në varësi të tipeve të njësive ekonomike, etj.

Dhe një herë duke Ju falenderuar për pjesëmarrjen, i uroj kësaj konference punime të mbara!